



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.332/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Zyhdi Haziri dhe Adnan Konushevcu anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtarës së Lartë Ligjor Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, për shkak të thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 22.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, me të cilën kërkohet që ti shqiptohet dënimi me gjobë ndaj subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, për shkak të thyerjes së Heshtjes Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

Me datën 22.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga BIRN dhe Internews Kosova, me të cilën pretendon se me datë 21.10.2017 kandidati për anëtarë Kuvend Komunal të Ferizajt, nga radhët e subjektit politik AAK, ka bërë fushatë duke shpërndarë fotografi në facebook, në të cilën bënë thirrje për të votuar Arbër Ibrahimimi. Me këtë rast parashtuesi i ankesës thekson se subjekti politik AAK ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 36.1 pika b) të LZP-së.

Parashtuesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuar lidhur me rastin në fjalë.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore të parashtuesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e subjektit politik AAK, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tillë e refuzoj ankesën, për faktin se, veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të nenit 36.1 pika b) e LZP-së, për arsye se kandidati për anëtarë të kuvendit të Komunës së Ferizajt nga radhët e subjektit politik AAK, nuk ka mundur të vërtetoj se ka bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore pasi që nga fotografitë e shpërndara në rrjetin social facebook, nuk mund të identifikohet koha dhe data e shpërndarjes së të njejtave.

Andaj në mungesë dëshmive të qarta dhe bindëse siç kërkohen me nenin 117 të LZP-së paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

Nga arsyet e theksuar më lartë e duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL. Anr.332/2017 më datën 22.10.2017.

Kryesuesi i Panelit
Gyltene Sylejmani



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.